



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1978 Prot

Tiranë, më 13 / 12 / 2019

REKOMANDIM

Nr. 68, datë 13 / 12 / 2019

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
SË AUTORITETIT PUBLIK “MINISTRIA E DREJTËSISË”

Në mbështetje të neneve 6, 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare: http://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/PROGRAMI-I-TRANSPARENCES_MD_WORD.pdf të Autoritetit Publik “Ministria e Drejtësisë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Gjithashtu, bazuar në pikën 2 të po të njëjtës dispozitë, në përgatitjen e programit të transparencës, Autoriteti Publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;

c) modelet e miratuara për kategorinë e Autoritetit Publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të Programit të Transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo Autoritet Publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, u krye monitorimi me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të transparencës në faqen zyrtare të Autoritetit Publik. Nga monitorimi i faqes rezulton se, autoriteti publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore në nënmenu-në “Dokumente”, dokumentin e programit të transparencës si dhe nën menunë Transparenca disa dokumente pjesë e Programit të Transparencës.

Nga verifikimi i rubrikave të programit rezultoi se, kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik pa kërkesë në përputhje me nenin 7 të ligjit, janë pjesërisht të linkuara në programin e transparencës, si dhe rezulton se disa informacione nuk janë të përditësuara.

Programi i transparencës duhet të jetë i plotësuar me të gjithë elementët sikurse parashikohet në ligj, si dhe i plotësuar me informacion specifik sipas fushës së veprimtarisë së çdo autoriteti publik.

Në lidhje me monitorimin e kryer Zyra e Komisionerit vlerëson se, problematikat e evidentuara konsistojnë në mosvënien në zbatim të programit të transparencës, në përputhje me modelin e miratuar nga Komisioneri.

Nga monitorimi u konstatua se nuk është publikuar/publikuar pjesërisht informacioni në përputhje me nenin 7 pika 1 e ligjit, konkretisht për gërmat:

c) Informacioni mbi procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankesë;

d) Informacioni lidhur me të dhënat për arsimin, kualifikimet e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, si si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

dh) raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;

Disa kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 e ligjit, gjenden të publikuara pjesërisht në faqen zyrtare të autoritetit, por të pa ndërlidhura me programin e transparencës. Konkretisht si më poshtë:

f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi, u hartua raporti i monitorimit.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se një pjesë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet ti përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/ Ministria e Drejtësisë, në zbatim të gërmave a), b) dhe c), të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të rishikojë/përditësojë programin e transparencës;
2. Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit;
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni;
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit".

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13.12.2019

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



Raport monitorimi mbi implementimin e programit të transparencës së Autoritetit Publik/ Ministria e Drejtësisë – datë 25.11.2019


Ministria e Drejtësisë ka publikuar programin e transparencës në faqen zyrtare në linkun: http://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/PROGRAMI-I-TRANSPARENCES_MD_WORD.pdf

Nga monitorimi i faqes rezulton se, autoriteti publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore në nënmenu-në “Dokumente”, dokumentin e programit të transparencës, si dhe nën menunë Transparenca disa dokumente pjesë e Programit të Transparencë

Nga monitorimi rezulton se, Programi i transparencës është i publikuar në përputhje me programin model të transparencës të miratuar sipas Urdhërit nr.14 datë 22.01.2015 të Komisionerit. Gjithashtu rezulton se kategoritë e informacionit të programit model të transparencës, janë pjesërisht të ndërlidhura (të linkueshme) me informacionet përkatëse, si dhe një pjesë e informacioneve të bërë publik kanë mbetur të pa përditësuar.

7.1.a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik. Informacioni i detyrueshëm për tu publikuar sipas kësaj pike, rezulton publikuar dhe i ndërlidhur me programin e transparencës por nuk është lehtësisht i aksesueshem (nuk dallohet) dhe nuk është i përditësuar (shiko foton drejtorite)

The screenshot displays the official website of the Ministry of Justice of Albania. At the top, there is a navigation bar with links to 'Ministria', 'Program', 'Prioritete', 'Projekte', 'Publikime', 'Dokumente', 'Drejtësia për të Mitur', 'Newsroom', and 'Diaspora'. Below this is a large banner featuring the coat of arms of Albania and the text 'MINISTRIA E DREJTËSISË'. The main content area is titled 'Organigrama' (Organizational Chart). It shows a hierarchical structure starting with 'Ministria e Drejtësisë' at the top, followed by several departments and their respective units. To the right of the chart, there is a sidebar titled 'TE REJAT E FUNDIT' (Latest News) containing three news items with dates ranging from 10/11/2019 to 11/11/2019. The bottom of the page shows a Windows taskbar with various application icons and the system clock indicating 3:24 PM on 11/25/2019.



Ministria Program Prioritate Proiecte Publicitate Documente Dreptăria pe 16 Maiur Newsroom Dăruirea

 $A = \lambda$

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
KODIFIKIMIT DHE HARMONIZIMIT TE
LEGJISLACIONIT

Page 24

Contents

10

Copyright © 2004 John Wiley & Sons, Ltd.


DREJTORIA E PËRGJITHSHME
EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE
MBESHTETËSE

Katie Twiss

Ann. Entomol. Soc. Am.

[illegible]

• **•**



Ministria Program Prioritete Projekte Publikime Dokumente Drejtësia për të Mitur Newroom Diaspora

 $A \rightarrow A$ [illegible]

Măsură e Dreptate, ne părușim ne dăruim kryșare se poartă se părușim strănare dă ne
program e Cereșe, ușașon săptămână e sa ne țarășe ușaș


- TO RELATIVE FUNDING:

Bashkëpunimi kunder krimit të organizuar, Gjyriq
krah De Rahox: Grup pune për ndryshuar
legjislacionin. Papa kërkoi dhe propozime të tjera
për të ngritur shkallën e godësisë


Bastinașul este responsabil de asigurarea
organizării, desfășurării și finalizării
activității de învățare în cadrul
grupelor de lucru.

Fjolla e Minuskes së Orafitës së në Kurvent
11/11/2019


7.1.b) tekstet e plota: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë. **Informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës;**



7.1.c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës. **Informacioni është i publikuar pjesërisht në programin e transparencës, mungon informacioni mbi procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankesë;**




7.1.ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit. **Informacioni është i publikuar në faqen zyrtare të autoritetit si dhe është i ndërlidhur me programin e transparencës;**




7.1.d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime.

Mungon informacioni lidhur me të dhënat për arsimin, kualifikimet e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, si si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime. Informacioni i publikuar (CV vetëm e Ministrisë) në faqen e autoritetit publik <http://drejtesia.gov.al/ministrja/> dhe është i ndërlidhur me tabelën e Programit të Transparencës.



7.1.e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara. **Informacioni është pjesërisht i publikuar. Është publikuar monitorimi i buxhetit por mungon detajimi i buxhetit.**



vetem për vitin 2017 por referohet faqja e përgjithshme e APP.

Prokurimja dhe Aktet Protokoll 1.pdf 1/17

Bashkëlidhur po ju dorëojmë informata të cilat kanë procedurat e prokurimit të zhvilluara deri tani për vitin 2017 me kontratat:

- i) listën e kontratave të lidhura,
- ii) shumën e kontraktuar,
- iii) palët kontraktuese dhe përfaqësimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara.

Rreth rubrikës iv (Informacionet për zbatimin dhe monitorimin e kontratave) si dhe ndërtuesit e poltaka të ndërtimit, ju bëjmë me dije se monitorimi dhe zbatimi i kontratave të bashkuara nuk ndiqet dhe zbatohet nga Sektori i Prokurimeve.

Nr.	Emërtimi i procedurës Viti 2017	Kontraktuesi	Lloji i Procedurës	Vlera Kontrates Iftë (me taksë)
1	Mirëmbajtje dhe zhvillim i sistemit JCMIS, 2 vjet e 3 muaj	"akubINFO" sh.p.k	Procedurë e hapur	11 909 184
2	Përmirësimi i sistemit të mbikqerjes elektronike në fushën penale, 4 vjet e 1 muaj	BOE "Soft Solution" sh.p.k dhe "Fatech" sh.p.k dhe "Ratich" sh.p.k	Procedurë e hapur	233 952 000
3	Ri-konceptimi, përmirësimi dhe mirëmbajtja e sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përbashkëta A* RIS 4 vjet e 3 muaj	BOE "Soft Solution" sh.p.k dhe "Fatech" sh.p.k	Procedurë e hapur	67 080 000

15:00 PM 12/12/2019

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

KREU E PROKURIMIT RRETHIMESH LEGISLACIONE NJËFTIMET PROGRAMI TRANSPARENCES TË TËJERA LIDHJET

Regjistrimi i Porositësive

Regjistrimi i Porositësive

Drejtori Autoriteteve Kontraktuese dhe Operatorëve Ekonomikë

Në kuadër të Memorandumi të Bashkëpunimit Nr. 20.2 Priti datë 02.04.2019 të nënshkruar nga Zyrtarët e Përgjigjshëm.

Njoftimi

Në vijim të bashkëpunimit institucional Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoriteti i Konkurrencës kanë nënshkruar për Memorandumin e bashkëpunimit Nr. 20.2 Priti datë 02.04.

Dukejimi i Njoftimeve Publike

Njoftimi i kontratës së shpërndarë

Njoftimi i kështjës së kontratës

15:00 PM 12/25/2019


7.1.f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit – **Informacioni gjendet pjesërisht i publikuar në faqen e autoritetit por nuk është i ndërlidhur në programin e transparencës.**

7.1.g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik. **Informacioni nuk është i publikuar**


7.1.gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik; **Informacioni nuk është i publikuar**

7.1.h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

Informacioni është i publikuar në programin e transparencës;



7.1.i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji - **Informacioni i publikuar nuk është i përditësuar (përditësimi i fundit në muajin dhjetor 2018);**



7.1.k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh– **Informacioni është i publikuar në faqe por nuk është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**

7.1.l çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik . **Informacioni është i publikuar në faqe por nuk është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës**